



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Puniljeno/Prodato Received/Delivered	07-02-2024	4	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinitca Org./Unit	Nr. Post (tit. Post) Post. No.	Shkronja Titull Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHUK	742/2024		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1570/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, si dhe Avdyll Bektashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1570/2023 të datës 27.12.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga

kundër organit të punësimit/Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike "Kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 07.02.2024, mori këtë:

V E N D I M

I. Detyrohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që të nxjerr akt të shkruar administrativ, lidhur me Kërkesën e parashtruar me datë 08.11.2023 nga ankuesi,

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 27.12.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 7674/2023 të regjistruar nën shenjen A.nr.1570/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të zyrtarit kryesor administrativ të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, lidhur me Kërkesën e parashtruar me datë 08.11.2023 për kompensimin e shpenzimeve të operimit si pasojë e sëmundjes profesionale gjatë ushtrimit të detyrave të punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe

Vendosjes së Ankesave, me datë 29.12.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa kjo e fundit me datë 11.01.2023 ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit), me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 7674/2023 të datës 27.12.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emailin e datës 15.12.2023, 11.12.2023 nga anësi për D.L, Z.D dhe N.Sh; Emailin e datës 08.11.2023, 01.11.2023, 20.09.2023 nga anketuesi për D.L dhe Z.D; Emailin e datës 07.11.2023 nga Z.D për ankuesin; Emailin e datës 02.10.2023 nga R.B për ankuesin; Emailin e datës 25.09.2023 nga ankuesi për D.L, Z.D dhe R.B; Emailin e datës 19.09.2023, 12.09.2023 nga A.D për ankuesin; Emailin e datës 19.09.2023, 18.09.2023 nga ankuesi për A.D; Emailin e datës 03.09.2023 nga ankuesi; Emailin e datës 21.08.2023 nga ankuesi për Z.D etj; Emailin e datës 11.08.2023, 28.07.2023 nga ankuesi për AD. Dhe N.B; Emailin e datës 27.07.2023 nga Z.D për N.B dhe ankuesin; Vërtetimin e datës 22.09.2023 të lëshuar nga Spitali Amerikan; Raportin e Epikrizës i datës 22.09.2023 lëshuar nga Spitali Amerikan; Raport Specialistik i datës 19.08.2023; Raportin mjekësor i datës 21.08.2023, 01.09.2023; Foto; Raportin Specialistik i datës 31.08.2023; Raportin Specialistik i datës 31.08.2023; Fotografime mjekësore; Vendimin 01.Ref.Nr.61 i datës 19.01.2022; Vendimin Ref.02/Nr.313 i datës 21.09.2023; Vendimin Ref. 02/Nr.462 i datës 19.12.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 29.12.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 11.01.2023; Akt Emërimit e datës 29.03.2016; Emailin e datës 21.09.2023 nga R.B për E.A; Emailin e datës 21.09.2023 nga E.A për R.B; Raportin e ndërprerjes së përkohshme për punë i datës 18.09.2023; Dosjen e pushimeve të ankuesit për periudhën 01.01.2023 deri 31.12.2023; Emailin e datës 30.08.2022, 29.08.2022 nga Z.D për ankuesin; Emailin e datës 29.08.2022 nga ankuesi për M.S; Emailin e datës 29.08.2022 nga S.A; Emailin e datës 08.08.2022 nga V.R për Z.D; Emailin e datës 02.02.2022 nga Z.D për ankuesin dhe N.B; Emailin e datës 15.08.2023 nga Z.D për ankuesin; Emailin e datës 12.08.2023 nga L.Gj për ankuesin; Emailin e datës 08.08.2023 nga V.S për ankuesin; Emailin e datës 18.10.2023 nga Z.D për ankuesin dhe K.Th; Emailin e datës 18.10.2023 nga S.B për K.Th; Emailin e datës 26.07.2022 nga Z.D për ankuesin; Emailin e datës 20.07.2022 nga ankuesi për Z.D dhe K.Th; Emailin e datës 18.03.2022 nga ankuesi për Z.D; Emailin e datës 17.03.2022 nga Z.D për ankuesin; Emailin e datës 09.30.2022 nga A.L për K.R; Emailin e datës 07.30.2022 nga Z.D për K.R dhe A.L; Emailin e datës 07.03.2022 nga K.R për A.L.

Kolegji i Këshillit, nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se ankesa është e bazuar në kuptim të shqyrtimit të kërkesës nga zyrtari kryesor administrativ, dhe se janë plotësuar kushtet ligjore që të detyrohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që të nxjerr akt administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me shqyrtimin e kërkesës se parashtruar nga ankuesi, me datë 08.11.2023, *sepse:*

Nga provat e administruara të lëndës, rezulton se ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 29.03.2016 është i punësuar në pozitën e punës “Drejtor i Drejtoratit për Promovim të Sektorit Privat” në Agjencinë për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Tutje, sipas shkresave të lëndës, rrjedh se organi prekëset i punësimit me Vendimin me numër reference Ref:02/Nr.462 të datës 19.12.2023 të njëjtit i ka

aprovuar pushimin mjekësor me kompensim prej 70% të pagesë në kohëzgjatje prej 90 ditë pune dhe atë nga data 18.09.2023 deri me datë 25.01.2024.

Si rrjedhojë, ankuesi, duke ju referuar dispozitave të Ligjit Nr.04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, më datë 08.11.2023, i është drejtuar zyrtarit kryesor administrativ, gjegjësisht zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, me kërkesë për kompensimin e demit material dhe jo material, respektivisht kompensimin e shpenzimeve të operimit, për çka te njëjtit edhe i është aprovuar pushimi mjekësor me kompensim prej 70% të pagës në kohëzgjatje prej 90 ditë pune, mirëpo, sipas të ankuesit, deri në ditën e parashtrimit të ankesës, me datë 27.12.2023 nuk ka pranuar përgjigje me shkrim nga zyrtari kryesor administrativ në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Kolegj i Këshillit, në ndërlidhje me pretendimet ankimore të ankuesit ju referuar Ligjit Nr.04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, gjegjësisht me nenin 2 paragrafi 1, ku është përcaktuar se: *"1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen në sektorin publik, privat, publiko-privat dhe sektorin e administratës shtetërore të nivelit qendror dhe lokal"*, si dhe nenit 5 të këtij ligji, ku përcaktohet se: *"1. Punëdhënësi është përgjegjës për të krijuar kushtet e punës të sigurta dhe të shëndetshme në të gjitha aspektet e punës. 2. Punëdhënësi është i detyruar që të mbulojë të gjitha shpenzimet për kurimin e të punësuarit që ka pësuar lëndim në punë apo sëmundje profesionale, nëse nuk i ka siguruar në ndonjë kompani të sigurimeve të të punësuarit në pikëpamje shëndetësore. 3. Punëdhënësi është i detyruar të bëjë vlerësimin e hollësishëm mbi rreziqet për secilën vend të punës. 4. Punëdhënësi është i detyruar të udhëhiqet nga parimi i trajtimit të barabartë në marrjen e masave të sigurisë dhe shëndetit në punë për të gjithë të punësuarit"*, ndërsa lidhur me detyrimin e organit publikë që të shqyrtoj kërkesën dhe të nxjerr akt të shkruar administrativ, Kolegji i Këshillit ju referuar Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, respektivisht nenit 11 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2, ku përcaktohet se: *"3. Organi u siguron personave të interesuar dhe palëve informacion të saktë, të qartë dhe të kuptueshëm rreth: 3.2. kërkesave thelbësore ligjore si dhe procedurave e formaliteteve të parashikuara për nxjerrjen e një akti administrativ apo realizimin e një akti real të kërkuar, përfshirë këtu edhe dokumentet dhe deklaratat që duhen parashtruar"*, nenit 27 paragrafi 1, i cili përcakton se: *"1. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, zyrtari përgjegjës zhvillon procedurën administrative, vendos për çështjen, e nënshkruan vendimin si dhe siguron njoftimin e palës"*, nenit 97 paragrafi 1, i cili përcakton se: *"1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative"*, dhe si rrjedhojë duke u bazuar në kuadrin ligjor si me lartë, dhe marr parasysh faktin se ankuesit paraprakisht ju ka aprovuar pushimi mjekësor me pagesë nga organi përkatës i punësimit, i cili pushim sipas dispozitave ligjore në fuqi aprovohet si pasojë e lëndimit në punë ose sëmundjes profesionale të ndërlidhur me kryerjen e punëve dhe të shërbimeve për institucionin, Kolegji i Këshillit vlerëson se zyrtari kryesor administrativ në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, është i obliguar që fillimisht të analizoj Kërkesën e datës 08.11.2023 të ankuesit, në kuptim të ekzistimit të kompetencës lëndore, ngase sipas shkresave të lëndës ankuesi është i punësuar në një agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Nëse organi përkatës vlerëson se nuk ka kompetencë për vendosje t'ia kalojë kërkesën organit kompetent dhe do të njoftojë dërguesin për këtë sikurse parashihet me dispozitat e nenit 75 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, ndërsa nëse ekziston kompetenca për shkak se agjencia ekzekutive



ku është i punësuar ankuesi nuk ka linjë buxhetore sipas dispozitave të ligjit në fuqi, i njëjti organ detyrohet të shqyrtoj kërkesën e parashtruar nga ankuesi, se bashku me provat materiale të lëndës, dhe vetëm pas konstatimit të plot të gjendjes faktike dhe zbatimit të drejtë të ligjit material të nxjerr akt administrativ në pajtim me nenin 47 dhe nenin 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative.

Kështu që për sa me sipër dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.1570/2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

